



Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21 dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 dt. 21.06.2016, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe në bazë të kërkesës 05 nr. 350/02-106721/21 dt. 10.06.2021, për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit të caktimit të kushteve ndërtimore 05 nr. 350/02-129427/20 dt. 18.09.2020, dhe Vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e kushteve ndërtimore 05 nr. 350/03-233787/20 dt. 28.12.2020, në emër të pronarëve: Skender Zeka, Safet Zeka, Behije Zeka, Hava Suli, Sabri Suli, Gani Dedinca, Avni Dedinca, Muhamed Krasniqi, Adhurim Gashi, Halil Gashi, Fadil Gashi, Afrim Gashi, Osman Ramadani, Lulzim Berisha, Jakup Rustemi, Sanije Rustemi – Ibrahim, Nexhmije Latifi, Skender Krasniqi, Halit Hoti, Isa Miftari, Nuredin Krasniqi, Fehmi Dedinca, Nexhat Sylja, Hashim Krasniqi, Agim Veliu, Anita Zeka, Osman Grajçevci, Xheladin Beqiraj, Samedin Bajraktari, Fitim Shala, Hajrullah Tërdevci, Sinan Shaqiri, Rrahman Sheqiri, Hajdar Sheqiri, Elmaz Sheqiri nga Prishtina, me investitor “DP&Partners” shpk, me pronar Durim Prishtina nga Prishtina, për lejimin e ndërtimit të kompleksit me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm, në kuadër të Bllokut Urban “C6”, tërësia “C”, të Planit Rregullues “Mati 1” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 29.07.2021, merr këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS 05 nr. 350/02-106721/21 dt. 10.06.2021 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE 05 nr. 350/02-129427/20 dt. 18.09.2020

I. Miratohet kërkesa 05 nr. 350/02-106721/21 dt. 10.06.2021, e parashtruar nga pronarët: Skender Zeka, Safet Zeka, Behije Zeka, Hava Suli, Sabri Suli, Gani Dedinca, Avni Dedinca, Muhamed Krasniqi, Adhurim Gashi, Halil Gashi, Fadil Gashi, Afrim Gashi, Osman Ramadani, Lulzim Berisha, Jakup Rustemi, Sanije Rustemi – Ibrahim, Nexhmije Latifi, Skender Krasniqi, Halit Hoti, Isa Miftari, Nuredin Krasniqi, Fehmi Dedinca, Nexhat Sylja, Hashim Krasniqi, Agim Veliu, Anita Zeka, Osman Grajçevci, Xheladin Beqiraj, Samedin Bajraktari, Fitim Shala, Hajrullah Tërdevci, Sinan Shaqiri, Rrahman Sheqiri, Hajdar Sheqiri, Elmaz Sheqiri nga Prishtina, me investitor “DP&Partners” shpk, me pronar Durim Prishtina nga Prishtina, për ndryshimin e vendimit të caktimit të kushteve ndërtimore 05 nr. 350/02-129427/20 dt. 18.09.2020, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumëbanesore.

II. Ndryshimi dhe plotësimi i kushtet ndërtimore bëhet duke ia shtuar kompleksit edhe miratimin e fazës II-të. Miratimi i fazës II-të, rezulton me ndryshimin e emrave të pronarëve dhe parcelave kadastrale të trajtuara me vendimin e kushteve ndërtimore 05 nr. 350/02-129427/20 dt. 18.09.2020. Andaj, emrat e pronarëve të shënuar në vendimin e kushteve ndërtimore 05 nr. 350/02-129427/20 dt. 18.09.2020, ndryshohen në atë: Skender Zeka, Safet Zeka, Behije Zeka, Hava Suli, Sabri Suli, Gani Dedinca, Avni Dedinca, Muhamed Krasniqi, Adhurim Gashi, Halil Gashi, Fadil Gashi, Afrim Gashi, Osman Ramadani, Lulzim Berisha, Jakup Rustemi, Sanije Rustemi – Ibrahim, Nexhmije Latifi, Skender Krasniqi, Halit Hoti, Isa Miftari, Nuredin Krasniqi, Fehmi Dedinca, Nexhat Sylja, Hashim Krasniqi, Agim Veliu, Anita Zeka, Osman Grajçevci, Xheladin Beqiraj, Samedin Bajraktari, Fitim Shala, Hajrullah Tërdevci, Sinan Shaqiri, Rrahman Sheqiri, Hajdar Sheqiri, Elmaz Sheqiri nga Prishtina, me investitor “DP&Partners” shpk, me pronar Durim Prishtina nga Prishtina.

Bazuar në vendimin e kushteve ndërtimore 05 nr. 350/02-129427/20 dt. 18.09.2020, pronarët/investitor janë pajisur me vendimet e lejeve ndërtimore të ndërtesave të planifikuara për fazën e I-rë të kompleksit 05 nr. 351/02-201596/20 dt. 19.01.2021 dhe 05 nr. 351/02-25282/21 dt. 21.04.2021, gjegjësisht ndërtesat "A0", "A1", "A2", "A3" dhe "A4", ndërsa për fazën e II-të janë planifikuar ndërtesat "A5", "A6", "A7", "A8", "A9" dhe "A10", dhe atë si në vijim

"Faza I" - me përmbajtjet:

Lam. "A0" me etazhitet 2B+P+3,
Lam. "A1" me etazhitet 2B+S+P+7+Ph,
Lam. "A2" me etazhitet 3B+P+8+Ph,
Lam. "A3" me etazhitet 2B+S+P+8+Ph,
Lam. "A4" me etazhitet 3B+P+9,

"Faza II" - me përmbajtjet:

Lam. "A5", me etazhitet 2B+S+P+2,
Lam. "A6" me etazhitet 2B+S+P+9,
Lam. "A7" me etazhitet 2B+S+P+8+Ph,
Lam. "A8" me etazhitet 2B+P+1,
Lam. "A9" me etazhitet 2B+P+8+Ph,
Lam. "A10" me etazhitet 2B+P+8+Ph,

Ndërtesat e lartcekura planifikohen të shtrihen në kuadër të Bllokut urban "C6", tërësia "C", të Planit Rregullues "Mati 1" në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelat kadastrale nr. 1696-1 (parcelë kjo e ndarë dhe bashkuar sipas vendimit të kushteve ndërtimore), 783-2, 783-3, 783-6, 783-7, 783-4, 783-5, 785-15, 784-13, 785-11, 785-12, 785-9, 785-10, 784-2, 785-20, 785-13 ZK Matičan.

Gjendja ekzistuese e lokacionit - parcelave kadastrale të trajtuara, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqet, pronarët dhe klasa e kualitetit të parcelave kadastrale, janë:

- nr. 1696-1 ZK Matičan, me sipërfaqe prej 12538m², me destinim "Truall" (nga 12538m², bazuar në vendimet e lejeve ndërtimore, për "Faza I" janë shfrytëzuar 8822m²)
Sipërfaqja totale e shfrytëzuar S=8822m²

Parcelat kadastrale në "Faza II" të ndërtimit:

- nr. 1696-1 ZK Matičan me sipërfaqe prej 3716m², nga totali 12538m², me pronar: Nexhat Sylja, Fehmi Dedinca, Muhamed Krasniqi, Nuredin Krasniqi, Skender Zeka, Anita Zeka, Behije Zeka, Safet Zeka, Sabri Suli, Isa Miftari, Hashim Krasniqi, Gani Dedinca, Hava Suli, Avni Dedinca, Halit Hoti, Skender Krasniqi, Osman Ramadani, Nexhmije Latifi, Sanije Ibrahim-Rrustemi, Jakup Rrustemi, Lulzim Berisha, Agim Veliu, Afrim Gashi, Fadil Gashi, Adhurim Gashi, Halil Gashi, "truall";
 - nr. 785-9, me S=405m², me pronar Isa Miftari..... "Arë e klasit 4";
 - nr. 785-10, me S=95m², me pronar Fehmi Dedinca..... "Arë e klasit 4";
 - nr. 785-11, me S=163m², me pronar Hashim Krasniqi..... "Arë e klasit 4";
 - nr. 785-12, me S=167m², me pronar Gani Dedinca..... "Arë e klasit 4";
 - nr. 785-15, me S=300m², me pronar Avni Dedinca..... "Arë e klasit 4";
 - nr. 785-20, me S=200m², me pronar Sanije Ibrahim-Rrustemi dhe Jakup Rrustemi..... "Arë e klasit 4"
 - nr. 785-21, me S=200m², me pronar Nuredin Krasniqi..... "Arë e klasit 4";
 - nr. 784-13, me S=200m², me pronar Osman Ramadani..... "Arë e klasit 4";
 - nr. 783-2, me S=617m², me pronar Lulzim Berisha..... "Arë e klasit 4";
 - nr. 783-3, me S=327m², me pronar Agim Veliu..... "Arë e klasit 4";
 - nr. 783-4, me S=382m², me pronar Muhamed Krasniqi..... "Arë e klasit 4";
 - nr. 783-5, me S=266m², me pronar Muhamed Krasniqi..... "Arë e klasit 4";
 - nr. 783-6, me S=265m², me pronar Muhamed Krasniqi..... "Arë e klasit 4";
 - nr. 783-7, me S=185m², me pronar Muhamed Krasniqi..... "Arë e klasit 4";
- Sipërfaqja totale S=7488m²**

E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjeve të planit dhe certifikatave të njësive kadastrale;

- Në kuadër të parcelave kadastrale të lartcekura, shtrihen ndërtesa si në vijim:
 - Në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1696-1 ZK Matiçan, shtrihen: 2 shtëpi me etazhitet P+0, 9 shtëpi me etazhitet P+9, 1 shtëpi me etazhitet P+Nk, dhe 4 shtëpi me etazhitet P+2;
 - Në kuadër të parcelës kadastrale nr. 783-2 ZK Matiçan, shtrihet 1 shtëpi, me etazhitet P+1;
 - Në kuadër të parcelës kadastrale nr. 783-3 ZK Matiçan, shtrihet 1 shtëpi, me etazhitet P+1;
 - Në kuadër të parcelës kadastrale nr. 783-6 ZK Matiçan, shtrihet 1 shtëpi, me etazhitet P+1;
 - Në kuadër të parcelës kadastrale nr. 783-7 ZK Matiçan, shtrihet 1 shtëpi, me etazhitet P+1;
 - Në kuadër të parcelës kadastrale nr. 783-4 ZK Matiçan, shtrihet 1 shtëpi, me etazhitet P+1;
 - Në kuadër të parcelës kadastrale nr. 783-5 ZK Matiçan, nuk ka ndërtesë të ndërtuar;
 - Në kuadër të parcelës kadastrale nr. 785-15 ZK Matiçan, shtrihet 1 shtëpi, me etazhitet P+1;
 - Në kuadër të parcelës kadastrale nr. 784-13 ZK Matiçan, shtrihet 1 shtëpi, me etazhitet P+2;
 - Në kuadër të parcelës kadastrale nr. 785-20 ZK Matiçan, shtrihet 1 shtëpi, me etazhitet P+1;
 - Në kuadër të parcelës kadastrale nr. 785-21 ZK Matiçan, shtrihet 1 shtëpi, me etazhitet P+1;
 - Në kuadër të parcelës kadastrale nr. 785-11 ZK Matiçan, shtrihet 1 shtëpi, me etazhitet P+1;
 - Në kuadër të parcelës kadastrale nr. 785-12 ZK Matiçan, shtrihet 1 shtëpi, me etazhitet P+1;
 - Në kuadër të parcelës kadastrale nr. 785-9 ZK Matiçan, shtrihet 1 shtëpi, me etazhitet P+1;
 - Në kuadër të parcelës kadastrale nr. 785-10 ZK Matiçan, nuk ka ndërtesë të ndërtuar;
- Janë toka urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj.;
- Terreni ka pjerrtësi të vogël nga drejtimi, me disnivel ~12.0m’;
- Qasja ekzistuese e parcelave kadastrale është në rrugën ekzistuese dhe e planifikuar;
- Parcelat kadastrale të lartcekura shtrihen në Bllokun Urban “C6”, tërësia “C”, dhe pjesërisht në rrugët e planifikuara të Planit Rregullues “Mati 1”;
- Në kuadër të perimetrit prej 50m’ të parcelave kadastrale, përfshihen ndërtesa individuale banimore, ndërtesa shumë banesore, etj.;

Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin-ndërtimin e kompleksit të ndërtesave shumë banesore dhe afariste, në kuadër të Bllokun Urban “C6”, tërësia “C”, të Planit Rregullues “Mati 1” në Prishtinë, bazuar në parametrat urban të planit, janë:

- Parcelat dhe pjesët e parcelave kadastrale me sipërfaqet e trajtuara, për realizimin e ndërtesave shumë banesore dhe afariste, konkretisht parcelat kadastrale të përfshira-të trajtuara brenda vijës rregulluese, për Faza I dhe II, janë:
 - nr.1696-1, me $S=12538m^2$ (sip. prej $8852m^2$ e trajtuar me “Faza I” dhe sip. prej $3716m^2$ e mbetur për “Faza II”);
 - nr.785-9, me $S=405m^2$;
 - nr.785-10, me $S=95m^2$;
 - nr.785-11, me $S=163m^2$;
 - nr.785-12, me $S=167m^2$;
 - nr.785-15, me $S=300m^2$;
 - nr.785-20, me $S=200m^2$;
 - nr.785-21, me $S=200m^2$;
 - nr.784-13, me $S=200m^2$;
 - nr.783-2, me $S=617m^2$;
 - nr.783-3, me $S=327m^2$;
 - nr.783-4, me $S=382m^2$;
 - nr.783-5, me $S=266m^2$;
 - nr.783-6, me $S=265m^2$;
 - nr.783-7, me $S=185m^2$;
- Sipërfaqe totale $S=16310m^2$;**

• Parcelat dhe pjesët e parcelave kadastrale me sipërfaqet e trajtuara, për realizimin e ndërtesave shumë banesore dhe afariste”, konkretisht parcelat kadastrale të përfshira-të trajtuara jashtë vijës rregulluese, janë:

- nr.1696-2, me $S=217m^2$;
Sipërfaqe totale $S=217m^2$;

Pasi që parcela kadastrale nr. 1696-2 ZK Matiçan, është trajtuar me “Faza I”, gjegjësisht me vendimet e lejeve ndërtimore të fazës parë 05 nr. 351/02-201596/20 dt. 19.01.2021 dhe 05 nr. 351/02-25282/21 dt. 21.04.2021, të lëshuara nga kjo Drejtori, parcela kadastrale është shpronësuar dhe njëjta në sistemin kadastral KCLIS, është në pronësi të “P.Sh. Kuvendi Komunal – Prishtinë” Pas plotësimit dhe ndryshimit, kalkulimi i sipërfaqeve të trajtuara për shpronësim do të jetë: $16310 \times 20\% = 3262m^2$, të lejuara, ndërsa sipërfaqja e parcelës e trajtuar për shpronësim është $S=217m^2 < 3262m^2$.

• Me këto kushte ndërtimore, në kuadër të parcelës ndërtimore, planifikohet të realizohen/ndërtohen ndërtesat shumë banesore dhe afariste, me sipërfaqe ndërtimore, shtrirje dhe etazhitet, sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit, si në vijim:

“Faza I” e ndërtimit e miratuar me vendimin e kushteve ndërtimore 05 nr. 350/02-129427/20 dt. 18.09.2020 dhe lejet ndërtimore 05 nr. 351/02-201596/20 dt. 19.01.2021 dhe 05 nr. 351/02-25282/21 dt. 21.04.2021:

Lamela “A0” – me etazhitet 2B+P+3, me sipërfaqe totale $S=5357.14m^2$ / mbi tokë $S=3116.92m^2$ dhe nën tokë $S=2240.22m^2$ /

Lamela “A1” – me etazhitet 2B+S+P+7+Nk, me sipërfaqe totale $S=6083.13m^2$ / mbi tokë $S=4575.89m^2$ dhe nën tokë $S=1507.24m^2$ /

Lamela “A2” – me etazhitet 3B+P+8+Nk, me sipërfaqe totale $S=8926.98m^2$ / mbi tokë $S=5983.60m^2$ dhe nën tokë $S=2943.38m^2$ /

Lamela “A3” – me etazhitet 2B+S+P+9, me sipërfaqe totale $S=7960.30m^2$ / mbi tokë $S=6180.0m^2$ dhe nën tokë $S=1780.30m^2$ /

Lamela “A4” – me etazhitet 2B+P+9, me sipërfaqe totale $S=9087.00m^2$ / mbi tokë $S=7205.30m^2$ dhe nën tokë $S=1881.70m^2$ /

Total sipërfaqe ndërtimore të projektuara për Faza I: $S=37414.54m^2$ / mbi tokë $S=27061.70m^2$ dhe nën tokë $S=10352.84m^2$

“Faza II” e ndërtimit:

Lamela “A5” – me etazhitet 2B+S+P+2, me sipërfaqe totale $S=5357.0m^2$ / mbi tokë $S=2660.0m^2$ dhe nën tokë $S=2697.0m^2$ /

Lamela “A6” – me etazhitet 2B+S+P+9, me sipërfaqe totale $S=8137.70m^2$ / mbi tokë $S=6059.0m^2$ dhe nën tokë $S=2078.70m^2$ /

Lamela “A7” – me etazhitet 2B+S+P+8+Ph, me sipërfaqe totale $S=5799.50m^2$ / mbi tokë $S=5210.0m^2$ dhe nën tokë $S=589.50m^2$ /

Lamela “A8” – me etazhitet 2B+P+1, me sipërfaqe totale $S=1158.64m^2$ / mbi tokë $S=775.70m^2$ dhe nën tokë $S=382.94m^2$ /

Lamela “A9” – me etazhitet 2B+P+8+Ph, me sipërfaqe totale $S=5188.15m^2$ / mbi tokë $S=3777.75m^2$ dhe nën tokë $S=1410.4m^2$ /

Lamela “A10” – me etazhitet 2B+P+8+Nk, me sipërfaqe totale $S=6496.0m^2$ / mbi tokë $S=4036.0m^2$ dhe nën tokë $S=2460.0m^2$ /

Total sipërfaqe ndërtimore të projektuara për Faza II: $S=32137.80m^2$ / mbi tokë $S=22519.25m^2$
dhe nën tokë $S=9618.55m^2$ /

Totali i projektuar “Faza I” dhe “Faza II”, do të jenë: $S=69552.34m^2$ / mbi tokë $S=49580.95m^2$ dhe nën tokë $S=19971.39m^2$ /

- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesave, sipas planit rregullues, të jetë për “banim”, si dhe “hapësira afariste”, si dhe me hapësira përcjellëse, si: kthina teknike, depo, hapësira të garazheve, etj.(sipas projekt propozimit të prezantuar);
- Etazhiteti maksimal i lejuar, sipas planit rregullues, është: për ngastrën ndërtimore “F” është IV-VIII, ndërsa sipas Planit Zhvillimor Urban është VII-IX, kurse i propozuar dhe i miratuar është sipas pikës 4, të këtij paragrafi.
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës ndërtimore- brenda vijës rregulluese (ISHP), sipas Planit Rregullues “Mati 1”, për vendosjen e ndërtesës në bazë-gabaritit në përdhese ose suterren, është max. 60%, kurse, sipas Planit Zhvillimor Urban, për vendosjen e ndërtesës në bazë-gabaritit në përdhese ose suterren, është max.40%, andaj, si i vlefshëm përcaktohet koeficienti i përcaktuar me PZHU, prej max.40%, dhe kjo sipërfaqe për këtë ndërtesën, duhet të jetë:

Parcela ndërtimore

$S = 16310 \times 0.4=6524.0m^2$; / lejuar sipas PZHU-së/

$S = 5731.77m^2$; /sipas projekt propozimit/

- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal i parcelës ndërtimore për nëntokë (ISHPN), sipas Planit Rregullues “Mati 1”, për vendosjen e ndërtesës në bazë - gabarit të bodrumit, është max. 60%, ndërsa bazuar në paragrafin II. pika 1. të Vendimit 01nr.031 – 185481 dt.14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për vendosjen e ndërtesës në bazë - gabarit të bodrumit është max. 60%, dhe kjo sipërfaqe për këtë kompleks, duhet të jetë:

Parcela ndërtimore

$S = 16310 \times 0.6=9786.0m^2$; / lejuar sipas Vendimit të Kryetarit/

$S = 9523.30m^2$; /sipas projekt propozimit/

- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal i parcelës ndërtimore për sipërfaqet gjelbëruese (ISHGJ) sipas planit rregullues, për ngastrën “F” është 20%, me gjelbërim të lartë dhe të ultë, si dhe hapësira të organizuara për sport dhe rekreacion, ndërsa sipas pikës 2, paragrafi II. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës 01-031-185481 dt. 14.08.2015, sipërfaqja e gjelbëruar e parcelës, e përcaktuar në bazë të Indeksit të Sipërfaqes së Gjelbëruar, duhet të jetë së paku 40%, përjashtimisht kur ndërtohet kulmi me gjelbërim, kjo sipërfaqe mund të jetë së paku 30%, dhe kjo sipërfaqe për këtë kompleks, duhet të jetë:

Parcela ndërtimore

$S = 16310 \times 0.4=6524.0m^2$; / lejuar sipas Vendimit të Kryetarit/

$S = 6551m^2$; /sipas projekt propozimit/

- Koeficienti i ndërtimit (ISPN) sipas Planit Rregullues “Mati 1”, është maksimum 3.0, për ngastrën ndërtimore “F”, ndërsa sipas Planit Zhvillimor Urban është “ndërtim i lartë” me koeficientat ndërtimore 1.8-3.0, andaj i vlefshëm përvetësohet koeficienti 3.0, dhe sipërfaqet e lejuara ndërtimore paraqiten si në vijim. Koeficienti ndërtimor i parcelave kadastrale të bashkuara brenda vijës rregulluese–parcelës ndërtimore, do të llogaritet si në vijim: **100%** për etazhet mbi kuotën ± 0.00 , **50%** për etazhet me vëllim mbi **51%** mbi tokë-suterren, dhe **0%** për etazhet e nëntokës-bodrome, dhe kjo sipërfaqe, për pjesën e parcelave brenda vijave rregulluese do të jetë do të jetë: Etazha e suterrenit duhet të jetë e destinuar për garazhim, bazuar në pikën 4, të nenit 6, të Rregullores për definimin e parametrave urban - arkitektonik të ndërtimeve dhe hapësirave gjelbëruese 01 -01 /01 -82553 121, me 12.05.2021, ku thuhet, “*Sipërfaqja e katit të suterrenit llogaritet tërësisht (100%) në ISN. Përjashtimisht nga kjo, do të llogaritet pjesërisht (50%) në ISN, nëse e njëjta sipërfaqe është planifikuar si hapësirë për garazhim*”

Parcela ndërtimore

$S = 16310m^2 \times 3.0 = 48930m^2$; / sipas Planit Rregullues/

- Bazuar në Vendimin 01 nr.400-660 dt. 26.05.2008, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës për kompensimin e pronës private planifikuar për interes publik me koeficient të ndërtimit, sipërfaqja e parcelës jashtë vijës rregulluese (deri në 20% të parcelës ndërtimore) mund të kompensohet, dhe sipas kalkulimit kjo sipërfaqe e shprehur në përqindje dhe bazuar në parcelën ndërtimore, duke i bashkuar grupin e I-rë dhe të II-të të interesit, sipërfaqja prej 20% do të jetë, $S=16310 \times 0.2$ (20%) = 3262.0m² (të lejuara), ndërsa sipërfaqja e parcelës kadastrale nr. 1696-2 ZK Matiçan, jashtë vijës rregulluese sipas dispozitës urbanistike të punuar nga gjeodeti i licencuar “Geo Horizont” sh.p.k. – Labinot Ademi, është 217m² (pika 3, paragrafi IV. i këtij Vendimi).
Pasi që sipërfaqja e parcelës që shtrihen jashtë vijës rregulluese të Bllokun Urban “C6”, tërësia “C”, ishte 217m², bazuar në Vendimit 01nr.400-660 dt. 26.05.2008, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës për kompensimin e pronës private planifikuar për interes publik me koeficient të ndërtimit, për këtë parcelë ndërtimore lejohej 217m², dhe se koeficienti ndërtimor për zonën në fjalë sipas PRRU dhe PZHU-së është 3.0, atëherë kompensimi me sipërfaqe ndërtimore është si në vijim:

$$217 \times 3.0 = 651 \text{ m}^2$$

Sipërfaqja totale ndërtimore e lejuar në tërësi do të jetë:

$$48930 \text{ m}^2 + 651 \text{ m}^2 = 49581 \text{ m}^2 \text{ të lejuara} / 49580.50 \text{ m}^2 \text{ të projektuar}$$

Pasi që parcela kadastrale nr. 1696-2 ZK Matiçan, është trajtuar me “Faza I”, gjegjësisht me vendimet e lejeve ndërtimore të fazës parë 05 nr. 351/02-201596/20 dt. 19.01.2021 dhe 05 nr. 351/02-25282/21 dt. 21.04.2021, të lëshuara nga kjo Drejtori, parcela kadastrale është shpronësuar dhe njëjta në sistemin kadastral KCLIS, është në pronësi të “P.Sh. Kuvendi Komunal – Prishtinë”

- “Kjo Drejtori me Vendimin 05 nr. 350/02-0055509/18 dt. 03.08.2018, ka caktuar kushtet ndërtimore për parcelën kadastrale me nr. 1644-2 ZK Matiçan, ku si pjesë e zgjidhjes urb-arkitektonike është miratuar rruga interne, e cila rrugë është paraparë të jetë vazhdimësi edhe për komplekset tjera brenda bllokut urbanistik “C6”. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë koordinatat e rrugës interne të planifikuar brenda bllokut e cila i ndanë dy grupet e interesave/investitorëve “Valoni Company” shpk, dhe “DP & Partners” shpk, si vazhdimësi e rrugës së planifikuar me Vendimin e kushteve ndërtimore 05 nr. 350/02-0055509/18 dt. 03.08.2018”;
- Bazuar në kriteret e planit rregullues, tipi i mbulimit d2, definohet në zonat me dendësinë më të lartë. Kjo mundëson ndërtimin e objektit me një gjatësi prej maksimum 25m’. dhe sipërfaqe te lire prej 0,4 x h-lartësia e ndërtesës ose se paku 3m. nga kufiri i parcelës.
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt.14.08.2016 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të kursimit dhe efijencës së energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Ngritja e nivelit të përdheses nga niveli i terrenit, nga rruga–niveli i terrenit duhet të jenë 1.2m’ për banim, ndërsa për afarizë D=30cm;
- Qasja në kompleks të jetë nga rruga e planifikuar e planit rregullues, të prezantuar në Planin e situacionit - “zgjidhjen urbane” të kompleksit;
- Parkimi i makinave për nevojat e pronarëve (shfrytëzuesve) të ndërtesave kolektive të banimit të sigurohet në parcelën ndërtimore në brendi të bllokut. Për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi, standardi i parkimit respektivisht i garazhimit është 1.0 (vend garazhi) sipas Planit Rregullues “Mati I” ose min.1.0 vendparkim sipas Rregullores MMPH nr.03/2016, për një banesë. Për pjesën e afarizmit min. 1 vendparkim për 30m² afarizëm. Garazhet e ndërtesave kolektive të banimit vendosen në apo nën ndërtesa, në gabaritin e ndërtesës, apo nën tokë jashtë gabaritet të ndërtesës. Kompleksi të organizohet edhe me vend-parkimet e jashtme, rrugët, shtigjet, trotuaret, terrenet sportive, këndet e lodrave për fëmijë, etj.;
- Në kuadër të kompleksit të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura/dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efijencës së energjisë, dhe ti përshtatet destinimit të ndërtesave të planifikuara;

- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që të jetë në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore.

Kompensimi / shpronësimi me koeficient ndërtimi i pjesës së parcelës kadastrale, nr. 1696-2 me $S=217m^2$, pjesë jashtë vijës rregulluese (deri në 20% të parcelës ndërtimore) e përfshirë në rrugët dhe gjelbërim të planifikuar, është mundësuar me koeficient ndërtimi, bazuar në Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës 01 nr.400-660 dt. 26.05.2008, me ç'rast sipas Vendimit të Kushteve Ndërtimore 05 nr. 350/02-129427/20 dt. 18.09.2020, të caktuara nga kjo Drejtori, është arritur Marrëveshje për shpronësimin e parcelës kadastrale nr. 1696-2 ZK Matiçan, të lidhur në mes të pronarëve të parcelës kadastrale dhe Drejtorisë së Pronës të Komunës së Prishtinës, me nr. 13-463/03-215119/20 dt. 15.12.2020, dhe sipërfaqja ndërtimore e lejuar për këtë parcelë $217 \times 3.0 = 651m^2$, është trajtuar me "Faza I", të kompleksit shumëbanesor.

Parcela kadastrale nr. 1696-2 ZK Matiçan, pas verifikimit të sistemit të të dhënave të parcelave KCLIS, është konstatuar se tani është parcelë në pronësi të "P.SH. Kuvendi Komunal Prishtinë".

Bashkimi i parcelave kadastrale nr. 1696-1, 785-9, 785-10, 785-11, 785-12, 785-15, 785-20, 785-21, 784-13, 783-2, 783-3, 783-4, 783-5, 783-6 dhe 783-7, ZK Matiçan, do të bëhet sipas parcelës ndërtimore bazuar në Plani i situacionit – "zgjidhja urbane" dhe manualin e bashkimit të parcelave, punuar nga gjeometri i licencuar, do të bëhet në bazë të grupeve të interesit në parcela ndërtimore.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për bashkimin e pjesëve të parcelave të lartcekura sipas, Planit të situacionit-"zgjidhja urbane" dhe manualit të bashkimit të parcelave, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e bashkimit të do të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve dhe investitorit, duke u bazuar në Plani i situacionit-"zgjidhja urbane" dhe manualin e bashkimit të parcelave, punuar nga gjeometri i licencuar, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore - Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore - meqenëse parcelat kadastrale brenda vijave rregulluese nr. 785-9, 785-10, 785-11, 785-12, 785-15, 785-20, 785-21, 784-13, 783-2, 783-3, 783-4, 783-5, 783-6 dhe 783-7, ZK Matiçan, në sipërfaqe prej $3772.0m^2$, janë evidentuar si kulturë bujqësore, kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 dhe 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokave bujqësore, të cilës do të ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, sipas Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore brenda vijës rregulluese, prej $S=3772.0m^2$. Kjo sipërfaqe e tokës do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.

Ky kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

Dokumentacioni ndërtimor - projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, "Rregulloren mbi normat minimale teknike për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi", të MMPH nr. 03/2016 dt. 04.11.2016, bazuar në UA nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, dhe Rregulloren për definimin e parametrave urban - arkitektonik të ndërtimeve dhe hapësirave gjelbëruese 0 1 -0 1 /0 1 -82553 121, me 12.05.2021, dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin - Planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m', me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;

- Situacionin - Planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë, relative dhe absolute;
- Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore-zejtare;
- Detajet e nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë, me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit, me rrugë, shtigje, mobiliarin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit-llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionimin dhe detaje e nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro – energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim", bazuar në Vendimin 01 nr.035-174324 dt.12.07.2016, e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;
- Elaboratin gjeomekanik, në bazë të analizave të terrenit;

III. Ky Vendim është pjesë e vendimit të kushteve ndërtimore 05 nr. 350/02-129427/20 dt. 18.09.2020, dhe Vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e kushteve ndërtimore 05 nr. 350/03-233787/20 dt. 28.12.2020, dhe i njëjti do të prodhoj efekte juridik nga dita e miratimit të tij.

A r s y e t i m

